



TIMSS 2011

Trends in International Mathematics and Science Study

Raporti mbi të arriturat e nxënësve në Republikën e Maqedonisë



Matematikë

Kimi

Fizikë

Biologji

Gjeografi

d-r Beti Llameva
Reshad Ramadani

*RAPORTI MBI TË ARRITURAT E NXËNËSVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË*

TIMSS 2011

(Trends in International Mathematics and Science Study)

Matematikë

Fizikë

Kimi

Biologji

Gjeografi

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

Autorë:

**d-r Beti Llameva
Reshad Ramadani**

Bashkëpunëtorë:

**Biljana Todorçevska
Semire Bilalli**

RAPORTI MBI TË ARRITURAT E NXËNËSVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË NË TIMSS 2011

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.091.279.7(497.7)“2011”(047)

LLAMEVA, Beti

Raporti mbi të arriturat e nxënësve në Republikën e Maqedonisë : TIMSS 2011 (trends in international mathematics and science study) / Beti Llameva, Reshad Ramadani. - Shkup : Qendra Shtetërore e Provimeve, 2013. - 107 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 106

ISBN 978-608-4692-02-7

а) Оценување - Основно воспитание и образование - Македонија - 2011 - Извештаји.

COBISS.MK-ID 93692938

Falënderim

Koordinatori nacional i Republikës së Maqedonisë për studimin ndërkombëtar TIMSS falënderon institucionet dhe individët e përfshirë në mënyrë aktive që kontribuan të realizohet kjo matje e të arriturave të nxënësve.

Mirënjohje e veçantë ndaj donatorëve: Zyrës së UNICEF-it në Shkup, USAID Maqedoni dhe Projektit për Modernizimin e Arsimit, financuar nga Banka Botërore të cilët siguruan mjete për kotizim për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë në këtë studim ndërkombëtar.

Mirënjohje për Organizatën Ndërkombëtare për Vlerësimin e të Arriturave Arsimore (International Association for the Educational Achievement - IEA) dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të cilët i besonin dhe jepnin përkrahje koordinatorit nacional në koordinimin dhe realizimin e aktiviteteve të parapara për tu realizuar brenda katër vitesh, meqë shteti ynë u përfshi pas realizimit të testimit provues, dhe ia doli t'i realizojë brenda dy viteve.

Mirënjohje e posaçme ndaj shkollave në të cilat u realizua testimi, arsimtarëve të matematikës dhe të grupit të lëndëve natyrore të cilët ishin pjesëmarrës në kontrollimin e testeve dhe personave që bënë regjistrimin e instrumentave në kompjuter. Tërë kjo u bë në kohë, pa asnjë kompensim financiar.

Ky studim nuk do të realizohej në kohë po të mos ishte kontributi dhe mbështetja e drejtorit të Qendrës Shtetërore të Provimeve z-ri Jusuf Arifi dhe të punësuarve tjerë të cilët punonin me vetëmohim në të gjitha detyrat e dhëna. Mirënjohje e posaçme ndaj tyre.


*d-r Beti Llameva,
koordinator nacional i TIMSS*





1. Hyrje

- 1.1. Çka paraqet TIMSS 2011
- 1.2. Çka mundëson përfshirja në këtë studim
- 1.3. Kush e realizoi TIMSS 2011
- 1.4. Ekzemplari
- 1.5. Instrumentat për grumbullimin e të dhënave
- 1.6. Korniza konceptuale e studimit



Njohuritë matematikore si dhe shkathësitë nga fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia, janë vendimtare për zhvillimin intelektual të çdo individi, si parakusht për arsimim të suksesshëm në të ardhmen dhe avansim profesional. Prandaj për çdo vend është me rëndësi vitale që kreatorët e politikës arsimore dhe hulumtuesit nga fusha e arsimit të dinë se në ç'masë është niveli i diturive matematikore dhe i diturive nga shkencat natyrore të nxënësve në përfundim të shkollimit të detyrueshëm dhe në kontinuitet si të përmirësohen në kontinuitet të arriturat e tyre.

1.1. Çka paraqet TIMSS 2011?

TIMSS (Trends in International Mathematics and Science Study) është një studim ndërkombëtar nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi), i cili bën matjen e diturive dhe aftësitë të nxënësve të klasave të IV dhe të VIII. Në vitin 2011 u realizua testimi kryesor me nxënësit e përfshirë në ekzemplar, prandaj edhe quhet TIMSS 2011. Republika e Maqedonisë deri më tani ka qënë pjesëmarrëse në tri cikle: TIMSS 1999, TIMSS 2003 dhe TIMSS 2011 me populacion vetëm nga klasa e VIII.

Matja e të arriturve të nxënësve në këtë studim ka dy dimensionë: përmbajtësor dhe kognitiv.

Në bazë të të dhënave të grumbulluara është bërë një analizë komparative mbi rezultatet e vendeve pjesëmarrëse karshi mesatares ndërkombëtare. Përmes pyetësorëve për nxënës, arsimtarë, drejtorë dhe për koordinatoret nacional fitohen të dhëna rreth asaj se si klima dhe kultura shkollore, praktika arsimore, qëllimet e programeve mësimore, kushtet socio-ekonomike të nxënësve dhe shkollave, rregullimi sistematik i arsimit dhe të tjera ndikojnë në të arriturat e nxënësve.

Në TIMSS 2011 (gjithsej nga klasa e IV dhe e VIII) u përfshinë 600000 nxënëses nga 63 shtete dhe 14 pjesëmarrës komparativ nga e gjithë bota. Më saktësisht, në TIMSS 2011 nga klasa e IV u përfshinë 52 shtete dhe 7 pjesëmarrës komparativ, kurse nga klasa e VIII 45 shtete dhe 14 pjesëmarrës komparativ.

Rezultatet e fituara nga pjesëmarrja e shteteve në ciklet paraprake të këtij studimi hapën shumë debate, përshpejtuan proceset e reformave dhe mundësuan fitimin e informatave valide dhe indikatorëve lidhur me sistemin e tyre nacional arsimor në perspektivat ndërkombëtare të kreatorëve të politikës arsimore dhe praktikuesve në çdo shtet. Indikatorët e sferave të hulumtuara janë bazë për analiza nga të cilat mund të arrihet të njohuritë mbi faktorët që ndikojnë në të arriturat e nxënësve. Pritet që edhe rezultatet nga TIMSS 2011 të kenë ndikim të ngjashëm apo më të madh.

Për përpilimin e këtij raporti u shfrytëzuan të dhëna nga raportet ndërkombëtare: TIMSS 2011 International Results in Science dhe TIMSS 2011 International Results in Mathematics.

Në hartimin e këtij raporti u shfrytëzuan të dhëna nga raportet ndërkombëtare: TIMSS 2011 International Results in Science dhe TIMSS 2011 International Results in Mathematics.

1.2. Çka mundëson përfshirja në këtë studim

Përmes pjesëmarrjes në studime ndërkombëtare të matjes së të arriturave të nxënësve po fitohen të dhëna të shumta mbi sistemet arsimore, programet arsimore, procesin arsimor, të arriturat e nxënësve, punën e arsimtarëve, si dhe realizimin e të arriturave të nxënësve në nivel ndërkombëtar. Që këtu, edhe pjesëmarrja në studimin TIMSS, u mundëson, para së gjithash kreatorëve të politikës arsimore sjelljen e vendimeve me qëllim të përmirësimeve në arsim duke u bazuar në të dhëna valide. Cilësia e lartë, të dhënat e krahasueshme ndërkombëtare mbi të arriturat e nxënësve në matematikë dhe shkencë janë të rëndësishme për përcjelljen dhe përmirësimin e sistemit të „shëndetshëm” arsimor. Realizimi i matjeve ndërkombëtare të këtilla shpesh bën nxitjen e reformave në arsim me qëllim të rritjes së cilësisë së arsimit.

Me përfshirjen e vendeve në studimet ndërkombëtare fitohen përgjigje në pyetje të rëndësishme, mes të cilave:

- cili është niveli i të arriturave të nxënësve dhe ku është vendi i shtetit në korniza ndërkombëtare, të arriturat e vendeve tjera, të cilat janë të rëndësishme për ne, si informacione lidhur me atë sesi po realizohet procesi arsimor në vendet të cilat korrin rezultate të mira;
- si është procesi arsimor, përgatitja e arsimtarëve dhe zhvillimi i tyre profesional tek ne dhe krahasimi me vendet tjera;
- si është organizimi institucional i punës edukativo-arsimore në sistemet arsimore të ndryshme nga sistemi ynë.

Rezultatet e studimeve ndërkombëtare shfrytëzohen për zhvillimin e mëtejshëm dhe modernizimin e sistemit arsimor, gjegjësisht procesit edukativo-arsimor lidhur me:

- caktimin e profilit të diturive themelore dhe aftësive të nxënësve;
- caktimin e të arriturave, qëllimeve dhe standardeve për përmirësime arsimore;
- stimulimin e reformave të programeve arsimore me qëllim të modernizimit të tyre;
- përmirësimin e arsimit dhe mësimin përmes hulumtimit dhe analizimit të të dhënave nga studimet;
- definimin e niveleve të të arriturave të nxënësve;
- aftësimin profesional dhe përsosjen e kuadrit arsimor;
- definimin e standardeve për vlerësimin e diturive të nxënësve në sferat që po testohen.

Përfshirja në këtë studim për Republikën e Maqedonisë është shumë e rëndësishme, para së gjithash për shkaqet vijuese:

- janë fituar të dhëna valide mbi njohuritë e nxënësve nga matematika dhe shkencat natyrore në përfundim të shkollimit fillor;
- janë fituar të dhëna valide për sistemin tonë arsimor, si dhe sistemet arsimore të vendeve pjesëmarrëse në studim;
- janë fituar njohuri mbi faktorët socio-ekonomikë dhe arsimor të cilët lidhen me të arriturat e nxënësve nga matematika, fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia;
- janë fituar të dhëna të vlefshme lidhur me realizimin e mësimdhënies në matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi në vendet tjera pjesëmarrëse në studim krahasuar me vendin tonë.

1.3. Kush e realizoi TIMSS 2011

Organizata Ndërkombëtare për Vlerësimin e të Arriturave Arsimore (International Association for the Educational Achievement - IEA) udhëheq me organizimin dhe realizimin e këtij studimi. Sot në këtë organizatë me përvojë mëse dyzetvjeçare në realizimin e studimeve të këtilla bëjnë pjesë më shumë se shtatëdhjetë vende nga e gjithë bota. IEA ka Sekretariat të Përgjithshëm me seli në Amsterdam, Holandë dhe Qendrën për Hulumtim dhe Përpunimin e të Dhënave në Hamburg, Gjermani. Punën profesionale dhe menaxhimin e studimit e drejton Qendra Studimore Ndërkombëtare (International Study Center - ISC) në Boston. Përveç tyre në realizimin e aktiviteteve të këtij studimi marrin pjesë edhe Statistika e Kanadasë (Statistics Canada) nga Otava dhe Servisi për Testime në Arsim (Educational Testing Service) nga Prinstoni, Nju Xherisi.

Çdo vend i përfshirë në studim ka koordinatoren e tij nacional i cili është anëtar i ekipit ndërkombëtar të koordinatorëve nacional.

Republika e Maqedonisë përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në vitin 2010 u përfshi në studimin ndërkombëtar TIMSS 2011. Kotizimi për pjesëmarrje në këtë projekt ndërkombëtar u sigurua nga ana e Zyrës së UNICEF-it në Shkup, USAID Maqedoni dhe Projektit për Modernizimin e Arsimit, financuar nga Banka Botërore. Realizues i studimit ishte Qendra Shtetërore e Provimeve.

1.4. Ekzemplar

Në TIMSS 2011 morën pjesë 63 shtete dhe 14 pjesëmarrës komparativ nga e gjithë bota. Populacioni në këtë studim janë nxënësit e klasave të IV dhe të VIII nga vendet pjesëmarrëse. Me populacionin e klasës së IV u përfshinë 52 vende dhe 7 pjesëmarrës komparativ, kurse nga klasa e VIII u përfshinë 45 vende dhe 14 pjesëmarrës komparativ. Shteti ynë mori pjesë vetëm me populacion të nxënësve të klasës së VIII.

Secili vend pjesëmarrës i përfshirë merrte pjesë me 4000 nxënës nga 150 shkolla të përzgjedhura rastësisht, drejtorët e shkollave të përzgjedhura dhe arsimtarët e matematikës dhe të grupit të lëndëve natyrore që u ligjërojnë nxënësve të përfshirë në studim.

Nga Republika e Maqedonisë populacioni për këtë studim ishin të gjithë nxënësit e klasës së VIII nga shkollat fillore në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe/edhe në gjuhën shqipe. Mosha mesatare e nxënësve në kohën kur u testuan të ne është 14,7 vjeç.

Përzgjedhjen e shkollave e bëri Statistika Kanada sipas metodologjisë së zgjedhjes së rastësishme, ndërsa zgjedhjen e paraleleve e bëri koordinatori lokal gjithashtu me zgjedhje të rastësishme, duke përdorur një program të specializuar kompjuterik për këtë qëllim.

Ekzemplari përfshiu 150 shkolla fillore, nga të cilat: 86 në gjuhën mësimore maqedonase, 35 në gjuhën mësimore shqipe dhe 29 dygjuhësore, përkatësisht në gjuhën mësimore maqedonase dhe shqipe. Në ekzemplar u përfshinë:

- 204 paralele me 4360 nxënës;
- 150 drejtorë shkollash;
- 204 arsimtarë të matematikës;
- 816 arsimtarë të fizikës, kimisë, biologjisë ose gjeografisë.

Nga 4360 nxënësit e përzgjedhur vetëm 208 mungonin ditën e testimit dhe 67 në ndërkohë kishin ndërruar shkollën. Gjithashtu gjatë përpunimit të rezultateve u lanë anash edhe të arriturat e fëmijëve me nevoja të posaçme arsimore (tek ne kishte 23 të tillë). Domethënë u, përpunuan gjithsej 4062 intrumenta nga nxënësit, përkatësisht rreth 95% e nxënësve në ekzemplar.

1.5. Instrumentat për grumbullimin e të dhënave

Dituritë e nxënësve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore (fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia) u vlerësuan me anë të testeve, ndërsa të dhënat rreth faktorëve që ndikojnë në të arriturat e nxënësve u fituan nga pyetësorët.

Testet dhe instrumentat tjerë me anë të së cilëve u grumbulluan të dhënat për këtë studim u përkthyen në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

1.5.1. Testet

Në këtë studim u shfrytëzuan 14 teste, të ndarë në dy pjesë dhe zgjidheshin në sesione testimi (me nga 45 minuta) me pauzë ndërmjet sesioneve.

Rreth 50% e çdo testi përmbante pyetje dhe detyra nga matematika, kurse gjysma tjetër nga: fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia. Pyetjet dhe detyrat në teste ishin me përgjigje me më shumë alternativa (me përzgjedhje të njërës nga përgjigjet e ofruara), përgjigje të shkurtëra dhe të tipit të hapur në të cilat kërkohej arsyetim, sqarim apo veprim për zgjidhje të tërësishme. Niveli i kërkesave të pyetjeve dhe detyrave në teste ishte i ndryshëm nga njohja e fakteve, nocione, strategji, terme, procese, aplikimi i tyre, si dhe të kuptuarit e tyre. Gjithsej, në të gjithë testet u përfshinë 217 detyra dhe pyetje të ndryshme nga matematika dhe shkencat natyrore.

Çdo nxënës i përfshirë në ekzemplar po zgjidhte nga një test i cili përmbante gjithsej rreth 50 pyetje dhe detyra.

Të gjitha pyetjet dhe detyrat u definuan përmes një procesi të konsensusit ndërkombëtar dhe u miratuan nga shtetet pjesëmarrëse në studim.

1.5.2. Pyetësorët

Anketimi nëpër shkolla u bë me 5 pyetësorë të ndryshëm edhe atë:

- pyetësor për nxënësit;
- pyetësor për arsimtarët e matematikës;
- pyetësor për arsimtarët e grupit të lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi);
- pyetësor për shkollën;
- pyetësor për koordinatorin nacional.

Pyetësorët për nxënës u dedikoheshin të gjithë nxënësve të përfshirë në ekzemplar dhe u realizua pas dy sesioneve të testimit. Me të u grumbulluan të dhënat personale të nxënësve, të dhëna rreth: shkollës, kushteve socio-ekonomike lidhur me të mësuarit matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi, të arriturat e nxënësve, përvoja individuale gjatë të mësuarit, detyrat e shtëpisë dhe të ngjashme.

Pyetësi për arsimtarët e matematikës dhe Pyetësi për arsimtarët e grupit të lëndëve natyrore u dedikoheshin të gjithë arsimtarëve që ligjëronin këta lëndë në paralelet e testuara. Me këta pyetësorë u grumbulluan të dhëna rreth përgatitjes profesionale të arsimtarëve, shkollës, realizimit të mësimdhënies, resurset që përdoren në mësimdhënie, temat që ligjërohen dhe përmbajtjet e përfshira në mësimdhënie sipas lëndës përkatëse për nxënësit e klasave të VIII, notimi i nxënësve dhe të ngjashme.

Pyetësi për shkollën i dedikoheshin drejtorit të shkollës në të cilën u realizua testimi. Me të u grumbulluan të dhëna rreth: mënyrës së regjistrimit në shkollë dhe karakteristikat, kohës mësimore, resurseve dhe teknologjive me të cilat disponon shkollë, përfshirjes së prindërve në punën e shkollës, klimës shkollore, arsimtarët në shkollë, aktivitetet e drejtorit dhe tjera.

Me Pyetësorët e veçantë në të cilët përgjigjej koordinatori nacional bashkë me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse u grumbulluan të dhëna lidhur me sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë, përmbajtjen e programeve mësimore nga matematika, fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia, institucionet që mbështesin arsimin dhe të ngjashme.

1.6. Korniza konceptuale e studimit

Matja e të arriturave me anë të këtij studimi kishte dy dimensione: përmbajtësore dhe kognitive. Në tabelat 1.1. dhe 1.2. është dhënë përfaqësimi i këtyre dimensioneve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore.

Tabela 1.1. Matematikë

Fusha përmbajtësore	% e përfaqësimit	Numri i pyetjeve	
		me më shumë zgjidhje	të hapura
Numra	30	31	30
Algjebra	30	37	33
Gjeometria	20	25	18
Puna me të dhëna	20	25	18
Fusha kognitive	% e përfaqësimit		
Njohuri	35	53	27
Aplikim	40	47	38
Rezonim	25	18	34

Tabela 1.2. Grupi i lëndëve natyrore

Fusha përmbajtësore	% e përfaqësimit	Numri i pyetjeve	
		me më shumë zgjidhje	të hapura
Biologji	35	38	41
Kimi	20	22	22
Fizikë	25	29	26
Gjeografi	20	21	18
Fusha kognitive	% e përfaqësimit		
Njohuri	30	58	15
Aplikim	35	40	52
Rezonim	35	12	40



2. Të arriturat e nxënësve

- 2.1. Mënyra e paraqitjes së rezultateve
- 2.2. Të arriturat nga matematika
- 2.3. Të arriturat nga grupi i lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi)

2.1. Mënyra e paraqitjes së rezultateve

Rezultatet e të arriturave të nxënësve të vendeve pjesëmarrëse në këtë studim, në raport janë paraqitur kështu:

- në shkallën e të arriturave janë dhënë rezultatet sumative të vendeve pjesëmarrëse¹;
- në shkallën në të cilën është shfaqur dallimi relativ mes të arriturave mesatare të nxënësve sipas fushave përmbajtësore;
- tabela me rezultatet mesatare të nxënësve sipas shkallëve të të arriturave dhe niveleve të rëndësisë së dallimeve midis rezultateve të nxënësve nga Republika e Maqedonisë dhe të nxënësve të vendeve tjera;
- tabela me përqindjen e nxënësve që kanë mbërritur nivelet për matematikë dhe grupin e lëndëve natyrore të definuara në këtë studim në bazë të treguesve empirik;
- tabela me të arriturat e grupeve të ndryshme të nxënësve nga Republika e Maqedonisë dhe të nivelit ndërkombëtar.

¹ TIMSS shfrytëzon teorinë e përgjigjes në detyrë provimi të bëjë përmbledhjen e rezultateve e të arriturave në shkallë me mesatare aritmetike 500 dhe devijim standard 100. Duke shfrytëzuar një dizajn testesh të pakompletuara, rezultati mesatar i nxënësit mund të gradohet në atë mënyrë që do të përlogariten dallimet në peshën e subseteve të ndryshme të detyrave të provimit.

2.2. Të arriturat nga matematika

2.2.1. Pikëpamjet e përgjithshme

Shkalla dhe tabela 2.2. tregojnë situatën e distribuimit e të arriturave të nxënësve të të gjitha vendeve pjesëmarrëse në këtë studim. Rezultatet e vendeve pjesëmarrëse janë shfaqur në një radhitje rënëse sipas rezultateve mesatare, gjatë së cilës janë dhënë indikatorët e nivelit të rëndësisë të dallimit ndërmjet rezultatit mesatar të çdo vendi dhe mesit aritmetik ndërkombëtar.

Në grafikun janë shfaqur të arriturat e çdo vendi përmes pikëve percentile vijuese²:

- P5 – shumë nxënës me të arritura shumë të ulëta;
- P25 – nxënës me të arritura të ulëta;
- P50 – nxënës me të arritura mesatare;
- P75 – nxënës me të arritura të larta;
- P95 – nxënës me të arritura shumë të larta.

Nga kjo shkallë shkalla mund të konkludojmë që rezultati mesatar i nxënësve nga Republika e Maqedonisë në matematikë është 426 dhe dallimi midis rezultatit mesatar të të arriturave të nxënësve nga Republika e Maqedonisë dhe rezultatit mesatar ndërkombëtar për nxënës (500) statistikisht është e rëndësishme. Sipas tabelës, vendi ynë është në vendin e 29-të nga 42 vendet pjesëmarrëse në këtë studim të arriturat e të cilave po rangohen me popullacion të klasës së VIII. Rezultatet mesatare nga matematika edhe të 14 pjesëmarrësve komparativ janë më të mira nga rezultatet mesatare të të arriturave të nxënësve të Republikës së Maqedonisë. Në studim morën pjesë edhe 3 vende me popullacion nxënësish të klasës së IX. Rezultatet mesatare nga matematika të këtyre vendeve janë më të dobëta nga rezultatet mesatare të vendit tonë nga matematika. Nëse mirren parasysh të gjithë pjesëmarrësit në studim (pjesëmarrësit komparativ, vendet me popullacion të klasës së VIII dhe vendet me popullacion të klasës së IX) vendi ynë sipas të arriturave sipas të arriturave të nxënësve në matematikë është në vendin e 43-të nga 59 pjesëmarrës në studim.

Vendet të cilat patën të arritura më të larta nga matematika janë: Republika e Koresë, Singapori dhe Tajpei Kinez, kurse më të ulëta Maroku, Omani dhe Gana. Nga tabela mund të shihet që edhe Republika e Maqedonisë ka arritur rezultate më të ulëta nga të gjitha shtetet evropiane pjesëmarrëse në këtë studim.

² Pjesa e errët në anën e brendshme të vijës përcakton 95% interval besueshmërie të të arriturave mesatare të çdo vendi pjesëmarrës.

Tabela 2.1. Distribrimi i të arriturave nga matematika





Tabela 2.1. Distribrimi i të arriturave nga matematika



Krahasuar me të arriturat e nxënësve nga Republika e Maqedonisë ndërmjet dy cikleve paraprake të TIMSS-it në të cilat kemi marrë pjesë (TIMSS 1999 dhe TIMSS 2003), të dhënat treguan që rezultatet nga TIMSS 2011 janë më të ulëta³.

Tabela 2.2. Të arriturat nga matematika sipas gjinisë

	Vajza		Djem	
	% e nxënësve	të arriturat mesatare	% e nxënësve	të arriturat mesatare
Republika e Maqedonisë	49	430	51	423
Mesatarja ndërkombëtare	50	469	50	465

Nga nxënësit që morën pjesë në testim nga vendi ynë në këtë studim, 49% ishin vajza, kurse 51% djem. Në qoftë se krahasohen të arriturat e tyre mund të konkludojmë që, si në nivel ndërkombëtar, ashtu edhe tek ne, vajzat kanë arritur rezultate më të mira sesa djemtë⁴. Dallimi i mesatares ndërkombëtare është 4 pikë, kurse dallimi mesatar midis vajzave dhe djemve në Republikën e Maqedonisë është 7 pikë⁵. Ky dallim është më i madh në Oman dhe është 63 pikë, kurse në Marok nuk ka dallim midis të arriturave të vajzave dhe djemve.

Nëse shikohen rezultatet mesatare të nxënësve të vendit tonë në raport me gjuhën mësimore në të cilën po ndjekin mësimin, mund të konstatojmë që ekzistojnë dallime të theksuara statistikore midis të arriturave të nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase me të arriturat e nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe. Rezultate më të mira kanë arritur nxënësit që kanë ndjekur mësimin në gjuhën maqedonase⁶.

³ Në TIMSS 1999 të arriturat e nxënësve në Republikën e Maqedonisë janë 447, kurse në TIMSS 2003, 435.

⁴ Të arriturat e vajzave në TIMSS 2011 janë 430, kurse të djemve 423.

⁵ Në TIMSS 1999 dallimi mesatar midis të arriturave të vajzave dhe djemve në vendin tonë ishte më i vogël dhe përbënte vetëm 1 pikë.

⁶ Rezultati mesatar i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase është 452, kurse i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe është 375

2.2.2. Të arriturat e nxënësve nga fushat përmbajtësore

Pjesa nga matematika në të 14-të testet me të cilët u realizua ky studim përmbanin pyetje dhe detyra nga:

- Numra (numra natyror, numra të plotë, thyesa dhe numra decimal, përqindje, operacione me numra dhe vetitë e operacioneve);
- Algjebër (vargje numerike, shprehje numerike, shprehje algjebrike, barazime, jobarazime, proporcionalitet);
- Gjeometri (figura gjeometrike të rrafshit, trupa gjeometrik, elementet themelore të figurave dhe trupave, paraqitja në rrafsh, harmonia dhe të ngjashme);
- Puna me të dhëna (grumbullimi dhe organizimi i të dhënave, paraqitja dhe interpretimi i të dhënave, probabiliteti).

Tabela 2.3. Të arriturat mesatare nga fusha përmbajtësore për matematikë

Vendi	Rezultati i përgjithshëm mesatar	Rezultati mesatar sipas fushave përmbajtësore nga matematika			
		Numra	Algjebër	Gjeometri	Puna me të dhëna
Republika e Koresë	613 (2,9)	618 (2,6)	617 (3,2)	612 (2,7)	616 (2,5)
Singapori	611 (3,8)	611 (3,6)	614 (4,1)	609 (3,9)	607 (4,4)
Tajpei Kinez	609 (3,2)	598 (3,1)	628 (3,8)	625 (3,7)	584 (3,0)
Hong Kong-u	586 (3,8)	588 (3,7)	583 (3,9)	597 (4,3)	581 (4,1)
Japonia	570 (2,6)	557 (3,0)	570 (3,0)	586 (3,5)	579 (3,0)
Federata Ruse	539 (3,6)	534 (3,2)	556 (3,7)	533 (4,0)	511 (3,9)
Izraeli	516 (4,1)	518 (4,0)	521 (4,7)	496 (4,6)	515 (4,8)
Finlanda	514 (2,5)	527 (2,4)	492 (2,9)	502 (2,9)	542 (3,1)
SHBA	509 (2,6)	514 (3,0)	512 (2,6)	485 (2,7)	527 (3,3)
Anglia	507 (5,5)	512 (5,8)	489 (5,7)	498 (5,7)	543 (6,8)
Hungaria	505 (3,5)	510 (3,9)	496 (4,0)	501 (4,1)	517 (4,3)
Australia	505 (5,1)	513 (5,4)	489 (5,3)	499 (5,4)	534 (5,9)
Sllovenia	505 (2,2)	511 (2,5)	493 (2,6)	504 (3,1)	518 (3,3)
Lituania	502 (2,5)	501 (2,5)	492 (2,8)	500 (3,1)	515 (2,8)
Italia	498 (2,4)	496 (2,9)	491 (2,7)	512 (3,5)	499 (3,2)
Zelanda e Re	488 (5,5)	492 (5,9)	472 (5,5)	483 (5,5)	513 (6,7)
Kazakistani	487 (4,0)	479 (4,0)	506 (4,4)	491 (4,4)	444 (4,5)
Suedia	484 (1,9)	504 (1,8)	459 (2,2)	456 (2,3)	504 (2,7)
Ukraina	479 (3,9)	472 (4,1)	487 (4,4)	476 (4,3)	471 (4,0)
Norvegjia	475 (2,4)	492 (2,8)	432 (2,7)	461 (3,5)	513 (3,6)
Armenia	467 (2,7)	474 (2,4)	496 (2,8)	450 (3,3)	376 (3,7)
Rumania	458 (4,0)	448 (4,1)	477 (4,3)	453 (4,5)	429 (4,0)
Emiratet e Bashkuara Arabe	456 (2,1)	459 (2,2)	468 (2,2)	431 (2,4)	440 (2,4)
Turqia	452 (3,9)	435 (3,9)	455 (4,2)	454 (4,3)	467 (4,0)
Libani	449 (3,7)	451 (3,8)	471 (3,8)	447 (3,8)	393 (5,2)
Malajzia	440 (5,4)	451 (5,8)	430 (5,2)	432 (6,4)	429 (5,3)
Gjeorgjia	431 (3,8)	435 (3,5)	450 (3,8)	406 (4,2)	392 (4,5)
Tajlanda	427 (4,3)	425 (4,6)	425 (4,3)	415 (5,4)	431 (4,1)
Republika e Maqedonisë	426 (5,2)	418 (5,1)	448 (5,3)	419 (6,0)	389 (5,9)
Tunizia	425 (2,8)	431 (2,8)	419 (2,9)	426 (3,2)	398 (3,3)
Kili	416 (2,6)	413 (2,9)	403 (3,6)	419 (3,1)	426 (3,1)
Irani	415 (4,3)	402 (4,9)	422 (4,3)	437 (4,8)	393 (4,9)
Katari	410 (3,1)	408 (3,4)	425 (2,8)	387 (3,6)	390 (3,6)
Bahrejni	409 (2,0)	397 (1,7)	424 (1,7)	398 (2,6)	407 (2,6)
Jordania	406 (3,7)	390 (3,8)	432 (3,9)	407 (3,7)	379 (3,7)
Palestina	404 (3,5)	400 (3,4)	419 (3,3)	416 (3,6)	368 (3,6)
Arabia Saudite	394 (4,6)	393 (4,8)	399 (4,9)	364 (5,3)	387 (5,1)
Indonezia	386 (4,3)	375 (4,8)	392 (3,8)	377 (5,3)	376 (4,8)
Siria	380 (4,5)	373 (4,0)	391 (4,9)	386 (5,0)	343 (4,7)
Maroku	371 (2,0)	379 (2,6)	357 (2,7)	390 (2,5)	332 (2,0)
Omani	366 (2,8)	351 (3,0)	383 (2,8)	377 (2,7)	342 (3,1)
Gana	331 (4,3)	321 (4,5)	358 (4,0)	315 (4,3)	296 (4,5)

Tabela 2.3. Të arriturat mesatare nga fusha përmbajtësore për matematikë

Vendi	Rezultati i përgjithshëm mesatar	Rezultati mesatar sipas fushave përmbajtësore nga matematika			
		Numra	Algjebër	Gjeometri	Puna me të dhëna
Pjesëmarrës me popullacion nga klasa e IX					
Bocvana	397 (2,5)	392 (3,3)	407 (3,2)	381 (3,0)	391 (3,2)
Karolina Veriore, SHBA	352 (2,5)	359 (2,6)	361 (2,5)	315 (3,1)	333 (3,4)
Hondurasi	338 (3,7)	352 (3,5)	327 (4,5)	309 (4,1)	319 (5,0)
Pjesëmarrës në komparacion					
Masaçusets, SHBA	561 (5,3)	567 (5,9)	559 (5,6)	548 (5,5)	584 (7,3)
Minesota, SHBA	545 (4,6)	556 (5,3)	543 (4,9)	515 (6,2)	571 (6,2)
Karolina Veriore, SHBA	537 (6,8)	547 (7,3)	537 (6,8)	515 (8,1)	548 (8,3)
Kuebek, Kanada	532 (2,3)	543 (2,5)	516 (2,9)	529 (2,7)	549 (2,8)
Indiana, SHBA	522 (5,1)	528 (5,4)	520 (5,3)	498 (5,3)	545 (6,0)
Kolorado, SHBA	518 (4,9)	521 (5,1)	512 (5,1)	505 (5,7)	540 (5,7)
Konektiket, SHBA	518 (4,8)	527 (4,9)	510 (5,4)	490 (5,1)	546 (6,3)
Florida, SHBA	513 (6,4)	517 (7,0)	513 (6,4)	499 (6,8)	528 (9,0)
Ontario, Kanada	512 (2,5)	519 (2,6)	497 (2,4)	512 (2,7)	531 (4,1)
Alberta, Kanada	505 (2,6)	523 (3,0)	485 (2,7)	485 (3,0)	529 (3,8)
Kalifornia, SHBA	493 (4,9)	492 (5,2)	509 (5,2)	454 (5,0)	495 (6,0)
Dubai, EBA	478 (2,1)	479 (2,3)	489 (2,4)	453 (3,0)	468 (2,8)
Alabama, SHBA	466 (5,9)	463 (7,1)	471 (5,3)	443 (6,0)	480 (7,9)
Abu Dabi, EBA	449 (3,7)	452 (3,8)	459 (3,8)	424 (4,4)	434 (4,3)

Në tabelën 2.3. janë dhënë rezultatet e disa vendeve pjesëmarrëse në studim të radhitura sipas radhës alfabetike sipas fushave nga matematika. Të arriturat e nxënësve në Republikën e Maqedonisë në çdo fushë janë dukshëm më të ulëta statistikisht nga mesatarja ndërkombëtare.

Krahasuar, pra, me rezultatet mesatare nga matematika në nivel nacional, nxënësit kanë rezultate më të larta në Algjebër, dhe vetëm ata janë më të larta nga mesatarja e matematikës (për të gjitha fushat), kurse nga fusha Puna me të dhëna janë më të ulëta. Nëse bëjmë krahasimin e rezultatit të nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase dhe të atyre që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe vijmë në konkludim të ngjashëm. Në Republikën e Maqedonisë pa marrë parasysh gjuhën në të cilën po ndjekin mësimin rezultate më të mira nxënësit tregojnë nga Algjebra, kurse më të dobëta nga fusha Puna me të dhëna. Por, brengosës është fakti që nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe kanë arritur rezultate dukshëm më të ulëta nga ata që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, kjo posaçërisht vjen në shprehje në fushën Puna me të dhëna⁷.

Rezultatet e nxënësve në Republikën e Maqedonisë dallojnë nga aspekti gjinor (Tabela 2.4.) si më poshtë, vajzat tregojnë rezultate më të larta nga djemtë në fushën Algjebër, Gjeometri dhe Puna me të dhëna. Rezultati mesatar i vajzave në Algjebër në Republikën e Maqedonisë është madje për 17 më i mirë nga rezultati mesatar i djemve. Ndërsa, vetëm në fushën Numra djemtë kanë rezultate më të larta nga vajzat.

Tabela 2.4. Të arriturat mesatare nga fushat përmbajtësore sipas gjinisë

Fusha	Republika e Maqedonisë		Mesatarja ndërkombëtare	
	vajza	djem	vajza	djem
Numra	416	421	464	468
Algjebër	457	440	476	464
Gjeometri	426	413	464	461
Puna me të dhëna	390	388	459	456

⁷ Rezultati mesatar për fushën Puna me të dhëna i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase është 429, ndërsa i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe është 310; për Gjeometri është 447 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, dhe 364 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe; për Numra është 442 за Броеви e 442 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, kurse 371 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe; për Algjebër është 470 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, dhe 405 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe.

2.2.3. Të arriturat e nxënësve sipas fushave kognitive

Në TIMSS 2011 është bërë matje e të arriturave të nxënësve edhe sipas fushave kognitive, siç vijon:

- njohje faktesh, rregullash, veprimesh dhe konceptesh të matura përmes aftësisë së nxënësve për të njohur, identifikuar dhe llogaritur;
- aplikim diturish dhe gjykim konceptual, matur përmes aftësisë së nxënësve të klasifikojnë, interpretojnë, zgjidhjen e problemeve të thjeshta;
- rezonim gjatë të cilit nxënësit shfaqin aftësi nga: lidhja, analiza, përgjithësimi, dëshmimi, si dhe zgjidhja e problemeve më komplekse jorutinore.

Sipas fushave kognitive Republika e Maqedonisë ka arritur rezultate prej 430 në Njohuri, 417 në Aplikim, kurse 424 në Rezonim. Nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe kanë arritur rezultate më të ulëta në mënyrë drastike nga ata që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase në të tria fushat kognitive⁸.

Tabela 2.5. Të arriturat nga fushat kognitive sipas gjinisë

Fusha	Republika e Maqedonisë		Mesatarja ndërkombëtare	
	vajza	djem		vajza
Njohuri	434	427	Njohuri	434
Aplikim	420	415	Aplikim	420
Rezonim	425	422	Rezonim	425

Dallimet e nxënësve nga Republika e Maqedonisë ndryshojnë nga aspekti gjinor, vajzat tregojnë rezultate më të larta nga djemtë në të tria fushat kognitive, ndërsa në nivel ndërkombëtar vetëm në fushën Aplikim, djemtë tregojnë rezultate më të mira nga vajzat. Situata është e ngjashme edhe në nivel ndërkombëtar.

⁸ Për fushën kognitive Njohuri rezultati mesatar i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase është 453, ndërsa i nxënësve që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe është 384; për Aplikim është 445 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, ndërsa 363 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe; për Rezonim është 454 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, ndërsa 363 për nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhën shqipe.

2.2.4. Rezultatet sipas nivelit ndërkombëtar të të arriturave të nxënësve dhe shembuj nga detyrat e testit

Të dhënat valide që fitohen nga pjesëmarrja në këtë studim para së gjithash i dedikohen kreatorëve të politikës arsimore që t'i ndihmojnë në sjelljen e vendimeve për reforma në arsim me qëllim të përmirësimit të cilësisë së tij. Gjatë kësaj, me rëndësi është që çdo njeri i ri të ketë njohuri matematikore, përkatësisht të posedojë dituri dhe aftësi nga fusha e matematikës të cilat pikësepri do ta ndihmojnë në jetën reale. Që të mundësohet një interpretim i këtillë i të arriturave nga TIMSS, në rrugë empirike janë përcaktuar katër pika në shkallën e të arriturave të cilat janë quajtur nivele ndërkombëtare të të arriturave edhe atë:

- Niveli i avansuar ndërkombëtar – i cili është përcaktuar sipas të arriturave të nxënësve më të mirë nga i gjithë popullacioni i testuar TIMSS dhe i përgjigjet 625 pikëve nga shkalla e të arriturave. Këta nxënës mund të organizojnë informacione, të përgjithësojnë, të aplikojnë dituritë e tyre, si dhe të nxjerrin konkludime duke u bazuar tek dhënat dhe informacionet e dhëna. Për zgjidhjen e problemeve të shkallëve të ndryshme nxënësit marrin të dhëna nga disa burime ose nga reprezentë të ndryshëm.
- Niveli i mesëm ndërkombëtar - i cili është përcaktuar në pajtim me 475 pikët nga shkalla e të arriturave. Nxënësit që kanë arritur këtë nivel mund të aplikojnë njohuritë themelore matematikore në situata të ndryshme, ata mund të zgjidhin probleme, përfshirë numrat decimal, funksionet, proporcionet dhe përqindjet. Ata kuptojnë nocionet e thjeshta algjebrike, termet elementare të gjasës, vizatimet dydimensionale dhe objektet tredimensionale. Ata mund të lexojnë, interpretojnë dhe paraqesin të dhëna të prezantuara në tabela dhe grafikona.
- Niveli i mesëm ndërkombëtar - i cili është përcaktuar në pajtim me 475 pikët nga shkalla e të arriturave. Nxënësit që kanë arritur këtë nivel mund të aplikojnë njohuritë themelore matematikore në situata të njohura ku po kërkohet në mënyrë eksplicite zbatimi i diturive. Ata mund zgjidhin probleme me lidhjet e thjeshta algjebrike, gjithashtu ata mund të bëjnë inkorporimin e vizatimeve dydimensionale në objekte tredimensionale, mund të lexojnë, interpretojnë dhe konstruktojnë grafikona dhe tabela. Ata mund të njohin nocionet themelore të gjasës.
- Niveli i ulët ndërkombëtar - i cili është përcaktuar në pajtim me 400 pikët nga shkalla e të arriturave. Nxënësit që kanë arritur këtë nivel kanë ca njohuri themelore nga matematika. Ata kanë ca njohuri të numrave të plotë dhe decimal, operacioneve dhe grafikonëve themelor.

Tabela 2.6. Përqindja e nxënësve të cilët arrijnë nivelin ndërkombëtar të të arriturave nga matematika në TIMSS 2011





Tabela 2.6. Përqindja e nxënësve të cilët arrijnë nivelin ndërkombëtar të të arriturve nga matematika në TIMSS 2011



Në shkallën nga tabela 2.6. në renditje rënëse sipas përqindjes së nxënësve të cilët kanë arritur nivelin më të lartë, janë dhënë të dhënat e nxënësve të çdo vendi pjesëmarrës si dhe nivelet e arritura ndërkombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë 3% të nxënësve kanë arritur nivelin e avansuar, 12% nivelin e lartë, 35% nivelin e mesëm, kurse vetëm 61% nivelin më të ulët. 19% e nxënësve që u testuan të patën rezultate shumë të ulëta, përkatësisht, mesatarisht vetëm 32% të testit e kanë zgjidhur saktë.

Tabela 2.7. Rezultatet e të arriturave të Republikës së Maqedonisë sipas niveleve nga TIMSS 1999, TIMSS 2003 dhe TIMSS 2011

Niveli	Përqindja e nxënësve		
	TIMSS 1999	TIMSS 2003	TIMSS 2011
niveli i avansuar ndërkombëtar	2	1	3
niveli i lartë ndërkombëtar	13	9	12
niveli i mesëm ndërkombëtar	40	34	35
niveli i ulët ndërkombëtar	70	66	61

Nga tabela e mësipërme mund të shihet që përqindja e nxënësve të cilët kanë arritur nivelin e avansuar ndërkombëtar nga matematika në TIMSS 2011 është më i madh në raport me TIMSS 1999 dhe TIMSS 2003. Nga ana tjetër, përqindja e nxënësve që kanë arritur nivelin e mesëm dhe nivelin e ulët ndërkombëtar është më e ulët krahasuar me TIMSS 1999 dhe TIMSS 2003. Kjo na shpie në konkludim që në Republikën e Maqedonisë është përmirësuar puna me nxënësit që arrijnë rezultate të larta është përmirësuar, për dallim nga ata që nuk e kanë arritur nivelin e mesëm dhe të ulët ndërkombëtar.

2.2.4.1. Shembuj nga detyrat e testit të nivelit të ulët ndërkombëtar

Niveli i ulët ndërkombëtar

Nxënësit që kanë arritur këtë nivel kanë disa njohuri të numrave të plotë dhe decimal, operacioneve dhe të grafikoneve themelorë.

Tabela 2.8. Niveli i ulët ndërkombëtar: shembull detyra 1 e testit

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Fusha përmbajtësore: Numra
		Fusha kognitive: Dituri
Singapori	94 (0,8) Δ	$42,65 + 5,748 =$ Përgjigje: <u>48,398</u>
Malajzia	91 (1,2) Δ	
Hong Kong-u	91 (1,5) Δ	
Kazakistani	90 (1,8) Δ	
Lituania	90 (1,5) Δ	
Federata Ruse	90 (1,2) Δ	
Tajpei Kinez	89 (1,1) Δ	
SHBA	89 (1,0) Δ	
Hungaria	88 (1,3) Δ	
Italia	88 (1,6) Δ	
Republika e Koresë	87 (1,5) Δ	
Sllovenia	85 (1,7) Δ	
Armenia	84 (1,9) Δ	
Tunizia	82 (1,8) Δ	
Izraeli	82 (1,4) Δ	
Australia	82 (2,0) Δ	
Norvegjia	81 (1,9) Δ	
Libani	81 (1,7) Δ	
Japonia	81 (1,6) Δ	
Ukraina	80 (2,4) Δ	
Emiratet e Bashkuara Arabe	79 (1,2) Δ	
Suedia	79 (1,7) Δ	
Anglia	79 (2,4) Δ	
Finlanda	79 (1,8) Δ	
Mesatarja ndërkombëtare	72 (0,3)	
Maroku	72 (1,7) Δ	
Katari	72 (1,5) Δ	
Zelanda e Re	70 (2,9) Δ	
Rumania	69 (2,5) Δ	
Arabia Saudite	65 (2,5) ∇	
Republika e Maqedonisë	65 (2,6) ∇	
Gjeorgjia	64 (2,9) ∇	
Tajlanda	64 (2,4) ∇	
Kili	58 (2,2) ∇	
Indonezia	57 (2,2) ∇	
Palestina	56 (1,9) ∇	
Oman	49 (1,6) ∇	
Turqia	48 (1,8) ∇	
Bahrejni	43 (2,3) ∇	
Irani	42 (2,2) ∇	
Jordania	36 (1,7) ∇	
Gana	36 (2,1) ∇	
Siria	31 (2,4) ∇	

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Vendi	Zgjidhjet në përqindje
Pjesëmarrës me popullacion nga klasa e IX		Pjesëmarrës në komparacion	
Bocvana	74 (1,4)	Masaçusets, SHBA	95 (1,3) Δ
Hondurasi	66 (2,3) ∇	Minesota, SHBA	93 (1,6) Δ
Afrika e Jugut	63 (2,0) ∇	Florida, SHBA	93 (1,8) Δ
		Alabama, SHBA	92 (2,5) Δ
		Konektiket, SHBA	91 (1,7) Δ
		Indiana, SHBA	90 (1,8) Δ
		Karolina Veriore, SHBA	90 (2,5) Δ
		Kuebek, Kanada	90 (1,4) Δ
		Kalifornia, SHBA	89 (1,4) ∇
		Alberta, Kanada	86 (1,3) ∇
		Ontario, Kanada	85 (1,7) ∇
		Kolorado, SHBA	82 (2,2) ∇
		Abu Dabi, EBA	81 (2,1) ∇
		Dubai, EBA	80 (2,1) ∇

Δ Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i lartë nga mesatarja ndërkombëtare

 ∇ Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i ulët nga mesatarja ndërkombëtare

Tabela 2.9. Niveli i ulët ndërkombëtar: shembull detyra 2 e testit

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Fusha përmbajtësore: Algjebër
Republika e Koresë	92 (1,0) Δ	Fusha kognitive: Dituri
Tajpei Kinez	91 (1,0) Δ	
Singapori	91 (1,1) Δ	
Federata Ruse	91 (1,6) Δ	
SHBA	89 (1,0) Δ	
Japonia	86 (1,5) Δ	
Kazakistani	86 (1,9) Δ	
Hong Kong-u	83 (1,8) Δ	
Lituanian	83 (1,8) Δ	
Ukraina	81 (2,5) Δ	
Hungaria	81 (1,7) Δ	
Armenia	81 (1,8) Δ	
Italia	80 (2,1) Δ	
Sllovenia	78 (2,1) Δ	
Finlanda	78 (1,8) Δ	
Rumania	75 (1,9) Δ	
Suedia	75 (1,7) Δ	
Anglia	73 (2,9) Δ	
Izraeli	72 (2,2) Δ	
Republika e Maqedonisë	71 (2,3) Δ	
Australia	71 (2,6) Δ	
Mesatarja ndërkombëtare	71 (0,3) Δ	
Norvegjia	70 (2,5) Δ	
Gjeorgjia	68 (2,2) Δ	
Katari	66 (1,6) ∇	
Turqia	66 (1,8) ∇	
Jordania	65 (2,2) ∇	
Indonezia	65 (2,4) ∇	
Kili	65 (2,1) ∇	
Siria	65 (2,3) ∇	
Emiratet e Bashkuara Arabe	64 (1,4) ∇	
Bahrejni	64 (2,1) ∇	
Tunizia	62 (2,0) ∇	
Zelanda e Re	61 (2,6) ∇	
Libani	60 (2,6) ∇	
Palestina	59 (1,8) ∇	
Arabia Saudite	57 (2,4) ∇	
Tajlanda	56 (2,2) ∇	
Irani	51 (2,5) ∇	
Gana	49 (2,1) ∇	
Omani	48 (1,5) ∇	
Malajzia	47 (2,1) ∇	
Maroku	45 (1,8) ∇	

$$y = \frac{a+b}{c}$$

$a = 8, b = 6$, dhe $c = 2$

Cila është vlera e y ?

☒ 7
☐ 10
☐ 11
☐ 14

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Vendi	Zgjidhjet në përqindje
Pjesëmarrës me populacion nga klasa e IX		Pjesëmarrës në komparacion	
Bocvana	62 (2,0) ∇	Masaçusets, SHBA	94 (1,3) Δ
Hondurasi	50 (2,1) ∇	Indiana, SHBA	93 (1,3) Δ
Afrika e Jugut	43 (1,4) ∇	Minesota, SHBA	92 (1,5) Δ
		Florida, SHBA	90 (2,2) Δ
		Kalifornia, SHBA	89 (2,1) Δ
		Karolina Veriore, SHBA	89 (2,5) Δ
		Konektiket, SHBA	88 (2,0) Δ
		Alabama, SHBA	84 (3,1) Δ
		Kolorado, SHBA	84 (2,2) Δ
		Ontario, Kanada	78 (2,0) Δ
		Kuebek, Kanada	75 (1,8) Δ
		Dubai, EBA	73 (1,9) Δ
		Alberta, Kanada	71 (2,2) Δ
		Abu Dabi, EBA	64 (2,3) ∇

Δ Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i lartë nga mesatarja ndërkombëtare

∇ Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i ulët nga mesatarja ndërkombëtare

*2.2.4.2. Примери на тест-задачи од интернационално средно ниво***Niveli i mesëm ndërkombëtar**

Nxënësit që kanë arritur këtë nivel mund të aplikojnë njohuri të thjeshta matematikore në situata të ndryshme, të zgjidhin probleme, përfshirë numrat decimal, funksionet, proporcionet dhe përqindjet. Ata kuptojnë shprehjet e thjeshta algjebrike, nocionet themelore të gjasës, vizatimet dydimensionale dhe objektet tredimensionale. Ata mund të lexojnë, interpretojnë dhe prezantojnë të dhëna nga tabelat dhe grafikonët.

Tabela 2.10. Niveli i mesëm ndërkombëtar: shembull detyra 3 e testit


Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Fusha përmbajtësore: Algjebër
Hong Kong-u	94 (1,3) Δ	Fusha kognitive: Dituri
Republika e Koresë	91 (1,3) Δ	Çka do të thotë $xy + 1$? (A) Numri 1 i shtohet numrit y, kurse pastaj shumëzohet me x. (B) x dhe y shumëzohen me 1. (C) Numri x i është shtuar y, kurse pastaj është shtuar numri 1. ● I shumëzuar x me y, kurse pastaj është shtuar numri 1.
Singapori	91 (1,1) Δ	
Tajpei Kinez	90 (1,3) Δ	
Federata Ruse	89 (1,2) Δ	
Japonia	87 (1,5) Δ	
Ukraina	81 (2,1) Δ	
SHBA	80 (1,2) Δ	
Armenia	79 (1,9) Δ	
Sllovenia	76 (2,0) Δ	
Lituania	75 (2,3) Δ	
Izraeli	74 (2,0) Δ	
Kazakistani	73 (1,9) Δ	
Hungaria	73 (1,9) Δ	
Finlanda	72 (2,2) Δ	
Anglia	72 (2,8) Δ	
Gjeorgjia	71 (1,8) Δ	
Australi	71 (2,3) Δ	
Jordania	69 (2,0)	
Emiratet e Bashkuara Arabe	66 (1,4)	
Mesatarja ndërkombëtare	65 (0,3)	
Italia	65 (2,0)	
Rumania	65 (2,3)	
Republika e Maqedonisë	63 (2,5)	
Bahrejni	62 (1,7)	
Zelanda e Re	60 (2,3) ∇	
Tajlanda	60 (2,5) ∇	
Libani	59 (2,6) ∇	
Turqi	58 (1,9) ∇	
Kili	58 (2,4) ∇	
Arabia Saudite	57 (2,2) ∇	
Palestina	56 (2,0) ∇	
Katari	55 (2,3) ∇	
Irani	55 (2,0) ∇	
Suedia	53 (2,0) ∇	
Tunizia	49 (1,8) ∇	
Indonezia	48 (2,3) ∇	
Siria	48 (2,2) ∇	
Omani	47 (1,7) ∇	
Malajzia	43 (2,0) ∇	
Maroku	41 (1,6) ∇	
Gana	36 (1,8) ∇	
Norvegjia	36 (2,6) ∇	

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Vendi	Zgjidhjet në përqindje
Pjesëmarrës me popullacion nga klasa e IX		Pjesëmarrës në komparacion	
Bocvana	52 (1,7) ∇	Masaçusets, SHBA	91 (1,9) Δ
Afrika e Jugut	30 (1,5) ∇	Minesota, SHBA	88 (2,1) Δ
Hondurasi	26 (2,0) ∇	Florida, SHBA	88 (2,6) Δ
		Indiana, SHBA	86 (1,6) Δ
		Karolina Veriore, SHBA	84 (2,1) Δ
		Konektiket, SHBA	83 (2,3) Δ
		Ontario, Kanada	81 (2,0) Δ
		Kalifornia, SHBA	79 (2,8) Δ
		Alberta, Kanada	78 (2,1) Δ
		Alabama, SHBA	77 (2,9) Δ
		Kolorado, SHBA	76 (3,3) Δ
		Dubai, EBA	72 (1,6) Δ
		Kuebek, Kanada	68 (2,0)
		Abu Dabi, EBA	63 (2,5)

Δ	Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i lartë nga mesatarja ndërkombëtare
∇	Rezultati mesatar i të arriturave është dukshëm më i ulët nga mesatarja ndërkombëtare

Tabela 2.11. Niveli i mesëm ndërkombëtar: shembull detyra 4 e testit

Vendi	Zgjidhjet në përqindje	Fusha përmbajtësore: Gjeometri
Japonia	89 (1,2) Δ	Fusha kognitive: Dituri
Finlanda	89 (1,1) Δ	
Australia	87 (1,2) Δ	
Republika e Koresë	85 (1,3) Δ	
Zealanda e Re	84 (1,7) Δ	
Singapori	83 (1,4) Δ	
Anglia	82 (2,1) Δ	
SHBA	81 (1,0) Δ	
Slovenia	81 (1,7) Δ	
Lituania	78 (1,7) Δ	
Hungaria	77 (1,9) Δ	
Hong Kong-u	77 (2,0) Δ	
Federata Ruse	75 (1,7) Δ	
Norvegjia	74 (2,4) Δ	
Tajpei Kinez	74 (1,7) Δ	
Kili	70 (1,8) Δ	
Italia	70 (2,3) Δ	
Izraeli	66 (1,9) Δ	
Suedia	65 (1,9) Δ	
Tabela 3.10. Të arriturat e nxënësve nga matematika që potencojnë suksesin akademik sipas përgjigjeve të drejtorëve dhe arsimtarëve të matematikës

Mendime		ndikim shumë i lartë		ndikim i lartë		ndikim i mesëm	
		% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.
drejtorë	Republika e Maqedonisë	3	439	64	440	33	403
	Mesatarja ndërkombëtare	7	495	53	477	41	449
arsimtarë të matematikës	Republika e Maqedonisë	4	420	45	435	51	414
	Mesatarja ndërkombëtare	5	506	48	478	47	452

Sipas mendimeve të drejtorëve të shkollave nga vendi ynë të cilat u përfshinë në këtë studim, të arriturat e nxënësve nga kategoria t ndikim shumë i lartë ndaj suksesit akademik dhe nga kategoria ndikim i lartë ndaj suksesit akademik pothuajse nuk ka dallime, kurse në nivelin ndërkombëtar ndryshimi ekziston. Në kategorinë ndikim i mesëm ndaj suksesit akademik në vendin tonë u përfshinë 33% të nxënësve të testuar, të arriturat e të cilëve janë 403, kurse në nivel ndërkombëtar 41% të nxënësve u klasifikuan në këtë kategori dhe të arriturat e tyre janë 449.

Ndërsa sipas mendimit të arsimtarëve të matematikës në kategorinë ndikimi i lartë bien 45% të nxënësve dhe të arriturat e tyre janë më të larta (435). Kurse në kategorinë ndikim shumë i lartë janë 4%, ndërsa në ndikim i mesëm bien 51% të nxënësve dhe të arriturat e tyre janë më të ulëta (414).

Tabela 3.11. Të arriturat e nxënësve nga grupi i lëndëve natyrore që potencojnë suksesin akademik sipas përgjigjeve të drejtorëve dhe arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore

Mendime		ndikim shumë i lartë		ndikim i lartë		ndikim i mesëm	
		% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.
drejtorë	Republika e Maqedonisë	3	426	64	422	33	383
	Mesatarja ndërkombëtare	7	504	53	486	41	460
arsimtarë të grupit të lëndëve natyrore	Republika e Maqedonisë	4	449	54	419	41	393
	Mesatarja ndërkombëtare	5	504	50	487	46	463

Sipas mendimeve të drejtorëve të shkollave nga vendi ynë që u përfshinë në këtë studim, të arriturat e nxënësve nga kategoria me ndikim shumë i lartë ndaj suksesit akademik dhe nga kategoria ndikim i lartë ndaj suksesit akademik dallojnë pak, kurse në nivel ndërkombëtar dallimi ekziston.

Në kategorinë ndikim i mesëm ndaj suksesit akademik në vendin tonë u përfshinë 33% të nxënësve të testuar, të arriturat e të cilëve janë 383, ndërsa në nivel ndërkombëtar 41% të nxënësve janë klasifikuar në këtë kategori dhe të arriturat e tyre janë 460.

Ndërsa, sipas mendimeve të arsimtarëve të matematikës në kategorinë ndikim i lartë janë 54% të nxënësve, dhe të arriturat e tyre janë më të larta (419). Në kategorinë ndikim shumë i lartë bien 4% të nxënësve dhe të arriturat janë më të larta (449) në kategorinë ndikim i mesëm bien 41% të nxënësve dhe të arriturat e tyre janë më të ulëta (393).

Në nivel ndërkombëtar pothuajse nuk ekziston dallim mes mendimeve të drejtorëve dhe arsimtarëve të lëndëve të grupit natyror.

Drejtorët e shkollave në shkallë tregradëshe (përmes kategorive: nuk i kushtova kohë, kohë të caktuar dhe shumë kohë) u përgjigjën se sa koha kanë shpenzuar vitin e kaluar duke kryer aktivitetet drejtuese si drejtor i shkollës.

Tabela 3.12. Mendimet e drejtorëve lidhur me kohën e shpenzuar duke kryer aktivitetet drejtuese si drejtor i shkollës vitin e kaluar

		Republika e Maqedonisë	Mesatarja ndërkombëtare
Përqindja e nxënësve, drejtorët e të cilëve u përgjigjën që merren me	Promovimi i vizionit dhe qëllimeve arsimore të shkollës	50	64
	Ideimin e planit mësimor dhe qëllimeve arsimore të shkollës	57	62
	Vëzhgimin dhe implementimin e qëllimeve arsimore të shkollës në punën e arsimtarëve	46	62
	Vëzhgimin e përparimit të nxënësve për të qënë të sigurt që shkolla i ka arritur qëllimet arsimore	53	65
	Mbajtja e disiplinës në shkollë	59	75
	Zgjidhjen e sjelljes joadekuate të nxënësve	42	54
	Këshillimin e arsimtarëve të cilët kanë pyetje apo probleme lidhur me mësimdhënien e tyre	37	44
	Inicimin e projekteve apo aktiviteteve arsimore	45	41
	Pjesëmarrje në aktivitete dedikuara zhvillimit profesional të drejtorëve të shkollave	43	40

Nga tabela 3.12. mund të shihet që drejtorët e shkollave fillore tek ne më së shumti kohë i kushtojnë mbajtjes së disiplinës në shkollë, pastaj ideimit të planit mësimor dhe qëllimeve arsimore të shkollës, kurse më pak kohë për këshillimin e arsimtarëve që kanë pyetje apo probleme lidhur me mësimdhënien e tyre. Edhe në nivel ndërkombëtar drejtorët më shumë kohë shpenzojnë në mbajtjen e disiplinës në shkollë, kurse më pak në pjesëmarrje në aktivitete dedikuara zhvillimit profesional të drejtorëve të shkollave.

Në pyetësin e arsimtarëve të matematikës dhe pyetësin e arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore, ata poashtu në shkollë katërgradëshe jepnin mendimet e tyre lidhur me sigurinë dhe disiplinën e nxënësve në shkollë. Më konkretisht, ata jepnin qëndrimet e tyre rreth: sa e sigurt është rrethina ku është vendosur shkolla e tyre, sa kënaq politika dhe praktika shkollore lidhur me sigurinë, sa korrekt sillen nxënësit, sa të disiplinuar janë dhe a shprehin nxënësit respekt ndaj arsimtarëve. Sipas mendimit të arsimtarëve shkollat u ndanë në tri kategoritë vijuese:

- të sigurta dhe të mirëmbajtura: së paku 3 nga 5 pohimet e ofruara të përgjigjura nga drejtorët me pajtohem shumë dhe të tjerat me pajtohem pak;
- të pasigurta dhe të mirëmbajtura: paku 3 nga 5 pohimet e ofruara të përgjigjura nga drejtorët me nuk pajtohem pak dhe të tjerat me pajtohem pak.;
- deri diku të sigurta dhe të mirëmbajtura – të gjitha tjerat të cilat nuk i takojnë asnjërës nga dy kategoritë e mëparshme.

Sipas përgjigjeve të arsimtarëve të matematikës 53% të nxënësve mësojnë në shkolla të kategorisë të sigurta dhe të mirëmbajtura ndërsa të arriturat e tyre janë 441. Në kategorinë deridiku të sigurta dhe të mirëmbajtura janë 44% të nxënësve dhe të arriturat e tyre janë më të vogla, gjegjësisht 402. Pjesa e mbetur prej 3% të nxënësve mësojnë në shkolla jo të sigurta dhe mirëmbajtura, por të arriturat e tyre (436) janë më të mëdha krahasuar me ata që mësojnë në shkolla deridiku të sigurta dhe të mirëmbajtura.

Sipas përgjigjeve të arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore 59% të nxënësve mësojnë në shkolla të kategorisë të sigurta dhe të mirëmbajtura ndërsa të arriturat e tyre janë 416. Në kategorinë deridiku të sigurta dhe të mirëmbajtura janë 38% të nxënësve dhe të arriturat e tyre janë më të vogla, gjegjësisht 400. Pjesa e mbetur prej 3% të nxënësve mësojnë në shkolla jo të sigurta dhe mirëmbajtura, por të arriturat e tyre (407) janë më të mëdha krahasuar me ata që mësojnë në shkolla deridiku të sigurta dhe të mirëmbajtura.

Pyetje e njëjtë iu parashtrua edhe drejtorëve të shkollave. Ata jepnin mendimin e tyre në shkallë katër gradëshe lidhur me prezencën në shkollën e tyre të: vonesave, mungesa pa arsye nga mësimi, çrregullimeve në mësim, mashtrimeve, vulgaritetit, vjedhjeve, trembjeve ose maltretimit verbal të nxënësve, shkaktimit të lëndimeve fizike nxënësve të tjerë, trembjeve ose maltretimit verbal të arsimtarëve apo të punësuarve të tjerë. Sipas përgjigjeve të tyre 16% të nxënësve mësojnë në shkolla në të cilat mezi ka probleme, kurse 64% të nxënësve mësojnë në shkolla në të cilat ka probleme të vogla. Të arriturat e këtyre dy grupeve të nxënësve janë të njëjta (432). Pjesa e mbetur e nxënësve prej 19% mësojnë në shkolla me probleme mesatare. Të arriturat e tyre janë më të vogla, gjegjësisht 411.

Lidhur me atë se si u ndjenë vitin e kaluar nxënësit në shkollë, përkatësisht a ishin të maltretuar u vendosën pyetje në pyetësorin për nxënësit. Ata në shkallë katër gradëshe po jepnin qëndrimet e tyre rreth: a ishin përqeshur dhe quajtur me emra të shëmtuar, a i shmangnin nxënësit që t'i përfshinin në lojrat dhe aktivitetet e tyre, a kishte përhapur dikush gënjeshtër për ta, a u ishte vjedhur diçka, a ishte goditur/lënduar nga ndonjë nxënësi tjetër dhe a ishte detyruar nga nxënësit tjerë të bënte diçka që nuk dëshironte. Sipas përgjigjeve të nxënësve u klasifikuan tri kategori: pothuaj se kurrë, ndonjëherë dhe shpesh. 68% të nxënësve konsiderojnë që pothuaj se kurrë nuk ishin maltretuar dhe të arriturat e tyre janë më të larta, gjegjësisht 445 për matematikë dhe 426 për grupin e lëndëve natyrore. Ndërsa të maltretuar shpesh janë 10% të nxënësve dhe të arriturat e

tyre janë më të ulëta (337 për matematikë dhe 357 për grupin e lëndëve natyrore), kursen pjesa prej 22% janë në kategorinë ndonjëherë të maltretuar, me të arritura 422 nga matematika dhe 404 për grupin e lëndëve natyrore. Në nivel ndërkombëtar 59% të nxënësve pothuaj se kurrë nuk kanë qënë të maltretuar (me të arritura 473 nga matematika dhe 483 për grupin e lëndëve natyrore), 12% shpesh të maltretuar (me të arritura 441 nga matematika dhe 452 për grupin e lëndëve natyrore) kurse pjesa tjetër prej 29% janë ndonjëherë të maltretuar (me të arritura 467 nga matematika dhe 478 për grupin e lëndëve natyrore).



4. Përgatitja e arsimtarëve

- 4.1. Programet mësimore nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore
- 4.2. Përgatitja e arsimtarëve të matematikës
- 4.3. Përgatitja e arsimtarëve të grupit të lëndëve mësimore



Në këtë studim në pyetësorët për nxënës, arsimtarë dhe koordinatorin nacional ishin vendosur më shumë pyetje me anë të së cilave po grumbullohen të dhënat lidhur me planet dhe programet mësimore nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore. Në studimin TIMSS u grumbulluan të dhëna në dy nivele: programet e rekomanduara arsimore dhe ajo që është realizuar përmes praktikës mësimore. Nga më shumë faktorë varet se sa do të realizohet ajo që është rekomanduar paraprakisht në dokumentet respektive.

4.1. Programet mësimore nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore

Programet mësimore në Republikën e Maqedonisë paraqesin dokument shtetëror, programet mësimore lejohen zyrtarisht dhe vlejnë për të gjithë nxënësit të cilët mësojnë në shkollat fillore shtetërore. E njëjta vlen pothuajse për të gjitha shtetet pjesëmarrëse në TIMSS 2011. Në disa vende pjesëmarrëse në studim programet mësimore nuk i sjell ministri, si për shembull Kili, Finlanda, Gjeorgjia, Hungaria, Rumania, Tunisi, Turqia, SHBA. Përmbajtjet e programeve të përcaktuara mësimore nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore për klasën e VIII në të gjitha vendet pjesëmarrëse në studim shpallen publikisht (përveç në Iran për matematikë) dhe përmbajnë qëllime dhe detyra. Në më shumë se gjysmën e tyre janë të përfshira edhe metodat e realizimit të mësimi dhe standartet për vlerësim, kurse në rreth gjysmën janë të cekura materialet arsimore. Në Republikën e Maqedonisë të gjitha çështjet e sipërpërmendura përfshihen në programet mësimore nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore.

Mësimi për grupin e lëndëve natyrore në arsimin fillor në botë realizohet sipas dy modeleve. Në njërin model, ata mësohen si lëndë të veçanta: fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi të cilat në varshmëri të vitit të arsimit realizohen të gjitha ose një pjesë e tyre. Nxënësit që u testuan me anë të këtij studimi ishin nga tetëvjeçarja. Mësimi zhvillohej sipas programeve të inovuara mësimore për arsim fillor tetëvjeçar dhe lëndët: fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi i mësonin si lëndë të veçanta siç është rasti tek më shumë vende europiane (përveç Anglisë, Skocisë, Italisë dhe Norvegjisë), si dhe në Indonezi, Marok, Filipine dhe Tajvan. Vendet e tjera përdorin modelin tjetër, përkatësisht të mësuarit e shkencave natyrore është vendosur një lëndë. Në të janë integruar përmbajtje nga më shumë lëmi. Sipas të arriturave të nxënësve nga vendet e ndryshme nuk mund t'i jepet përparësi njërit prej modeleve të të mësuarit të shkencave natyrore. Gjegjësisht, rezultatet e larta apo të dobëta nuk janë të lidhura me modelin e të mësuarit të grupit të lëndëve natyrore.

Sipas programeve të përcaktuara mësimore në Republikën e Maqedonisë sipas të cilave po realizohet mësimi tek nxënësit të cilët u testuan mund të konstatohet që: më tepër kujdes i kushtohet të kuptuarit të koncepteve të mësuara, rregullave dhe veprimeve, më pak njohurive mbi faktet e mësuara themelore, realizimit të eksperimenteve dhe hulumtimeve, lidhjes së përmbajtjeve me lëndët tjera mësimore, të kuptuarit mbi ndikimin e njeriut ndaj ambientit jetësor, kurse shumë pak vëmendje i kushtohet shkruarjes së raporteve dhe arsytimit lidhur me atë se çka është vëzhguar dhe si e sqarojnë nxënësit dukurinë, formulimin e hipotezave apo parashikimet që duhet të konfirmohen, planifikimin dhe realizimin e hulumtimeve, lidhur me esencën dhe natyrën e shkencave natyrore dhe hulumtimit të mësuar, për teknologjinë dhe ndikimin e saj në shoqëri dhe bashkëpunimin multikulturor.

Mund të konstatohet që në testet e TIMSS 2011 u përfshinë përmbajtjet e programeve mësimore nga matematika dhe shkencat natyrore në Republikën e Maqedonisë. Shumica e përmbajtjeve nga shkencat natyrore të cilat në vendet tjera pjesëmarrëse i mësojnë shumë më herët dhe më shumë vite, kurse tek ne janë të përfaqësuara vetëm në klasë të VII dhe të VIII.

Nga aspekti i testimeve eksterne dhe matjeve të të arriturave të nxënësve të cilët u përfshinë në këtë studim, në 40 vende në nivel kombëtar apo rajonal nga matematika ishin realizuar matje eksterne të të arriturave të nxënësve, kurse në 30 vende nga grupi i lëndëve natyrore.

Në Republikën e Maqedonisë në vitin 2006 u realizua matje eksterne e të arriturave të nxënësve – vlerësim nacional, në përfundim të klasës së VIII nga matematika. Me Ligjin e ri për arsim fillor tek ne janë paraparë kontrolle eksterne të të arriturave të nxënësve të cilat janë në fazë përgatitore.

4.2. Përgatitja e arsimtarëve të matematikës

Sa i përket përgatitjes profesionale të kuadrit arsimor të matematikës në Republikën e Maqedonisë 1% kanë të kryer më shumë se arsim sipëror, 33% janë me arsim sipëror, madje 65% janë me arsim të lartë. Ka dhe 2% arsimtarë të cilët janë me më pak se arsim të lartë.

Tabela 4.1. Përvoja e punës e arsimtarëve të matematikës dhe të arriturat e nxënësve nga matematika

	20 vjet ose më shumë		Nga 10 deri 20 vjet		Nga 5 deri 10 vjet		Më pak se 5 vjet		Mesatarisht vite përvojë pune
	% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.	% nx.	rez. mes.	
Republika e Maqedonisë	50	421	25	430	12	415	13	420	20
Mesatarja ndërkombëtare	36	474	28	470	19	463	18	458	16

Nga tabela 4.1. mund të shihet se tek ne nxënësit që i mësojnë arsimtarë të matematikës të cilët kanë përvojë pune ndërmjet 10 dhe 20 vjet arrijnë rezultate më të larta. Në nivel ndërkombëtar pamja është pak më ndryshe. Aq sa janë me të dhëna vitet e përvojës së punës së arsimtarëve të matematikës më të mëdha edhe të arriturat e nxënësve janë më të larta.

Në pyetësorët për arsimtarë nga TIMSS 2011 u grumbulluan të dhëna edhe për zhvillimin profesional të kuadrit arsimorë nga matematika në dy vitet e fundit. Në këto pyetje tek ne u përgjigjën më së paku 70% të arsimtarëve, por përfshirja e nxënësve që i mësojnë ata ishte më pak se 85%. Republika e Maqedonisë është mbi mesataren ndërkombëtare sipas përqindjes së arsimtarëve që janë trajnuar, më saktësisht është pothuajse në kulm. Përkatësisht, nxënësit e klasës së tetë mësoheshin nga: 79% të arsimtarëve të cilët kishin mbështetje në lidhje me realizimin e përmbajtjeve nga matematika, 67% të arsimtarëve të cilët kishin mbështetje pedagogjike për realizimin e orëve të matematikës, 81% të arsimtarëve të cilët kishin mbështetje në realizimin e programit arsimor, 90% kanë ndjekur trajnime për shfrytëzimin e teknologjisë informatike në arsim, 66% kanë ndjekur trajnim për përmirësimin e mendimit kritik të nxënësit ose zgjidhjen e problemeve dhe 90% janë trajnuar për vlerësim nga matematika.

Më tepër se 90% të nxënësve nga Republika e Maqedonisë i mësojnë arsimtarë të matematikës të cilët ndjehen “shumë mirë” të përgatitur për të mbajtur mësim nga matematika. Për fushat përmbajtësore: Numra, Algjebër dhe Gjeometri kjo përqindje është më shumë se 95%, kurse vetëm për Punë me të dhëna është rreth 75%. Në nivel ndërkombëtar kjo përqindje është më e ulët, përkatësisht për të gjitha lëmitë është 81%,

kurse sipas lëmvive është: Numra 92%, Algjebër 87%, Gjeometri 85% dhe Puna me të dhëna 62%.

Arsimtarët e matematikës u pyetën se kur ligjërojnë matematikë sa vetëbesim ndjejnë kur: përgjigjen në pyetjet e parashtruara të nxënësve nga matematika, u tregojnë nxënësve metoda të ndryshme për zgjidhjen e problemeve, sigurojnë detyra më të vështira për nxënësit e avansuar, përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës dhe i ndihmojnë nxënësit që të çmojnë vlerën e të mësuarit matematikë. Madje 95% të arsimtarëve ndjejnë shumë vetëbesim që çështjet e sipërpërmendura i bëjnë maksimalisht mirë. Të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë nga vendi ynë janë 427. Kjo përqindje e arsimtarëve është shumë mbi mesataren ndërkombëtare¹⁶. Para nesh për nga vetëbesimi i arsimtarëve të matematikës janë vetëm Kazakistani, Ukraina, Federata Ruse dhe Lituania, por të arriturat e nxënësve të tyre janë shumë më të larta nga ata të vendit tonë. Karakteristike është që arsimtarët e shteteve të cilat kanë arritur rezultate më të larta në TIMSS 2011 nga matematika (Republika e Koresë dhe Singapori) ishin mjaft modest në përgjigjen e dhënë kësaj pyetjeje¹⁷. Nëse shikohen sipas komponentave çështjet e sipërpërmendura mund të konkludojmë që 94% të nxënësve i mësojnë arsimtarë të cilët përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës dhe t'i ndihmojnë nxënësit të çmojnë vlerën e të mësuarit matematikë, kurse në nivel ndërkombëtar kjo është 65%. Në tabelën 4.2. janë dhënë sipas komponentave çështjet e sipërpërmendura.

¹⁶Mesatarja ndërkombëtare është 76%, kurse të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 470.

¹⁷Në Republikën e Koresë vetëm 50% të arsimtarëve ndjejnë shumë vetëbesim që i bëjnë maksimalisht mirë gjërat e sipërpërmendura, të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 613. Në Singapor vetëm 59% të arsimtarëve ndjejnë shumë vetëbesim që i bëjnë maksimalisht mirë gjërat e sipërpërmendura, të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 603.

Tabela 4.2 Komponentët e vetëbesimit të arsimtarëve kur ligjërojnë matematikë

	Përqindja e nxënësve, arsimtarët e të cilëve ndjejnë shumë vetëbesim kur ligjërojnë matematikë				
	përgjigjen në pyetjet e parashturara të nxënësve në matematikë	u tregojnë nxënësve metoda të ndryshme të zgjidhjes së problemeve	sigurojnë detyra më të vështira për nxënësit e përparuar	përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës	i ndihmojnë nxënësit që të çmojnë vlerën e të mësuarit matematikë
Republika e Maqedonisë	91	80	85	90	94
Mesatarja ndërkombëtare	87	77	65	62	65

Arsimtarët u pyetën rreth kënaqësisë së zhvillimit të karrierës së tyre. Ata jepnin mendimin e tyre në raport të shkallës katërgradëshe: se sa janë të përmbushur me profesionin e tyre, sa janë të kënaqur që janë arsimtarë në shkollën e tyre, a kanë pasur më tepër entuziazëm kur kanë filluar të ligjërojnë se sa tani, sa e rëndësishme është puna e tyre si arsimtar, a planifikojnë të vazhdojnë punën si arsimtar derisa të munden dhe a janë të frustruar si arsimtar. Sipas përgjigjeve të tyre:

- 44% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që janë të kënaqur, kurse të arriturat e atyre nxënësve janë 430;
- 51% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që janë pjesërisht të kënaqur, kurse të arriturat e atyre nxënësve janë 416;
- vetëm 5% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që janë të pakënaqur, kurse të arriturat e atyre nxënësve krahasuar me dy grupet e tjera janë më të larta dhe janë 444.

4.3. Përgatitja e arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore

Për sa i përket përgatitjes profesionale të kuadrit mësimdhënës të grupit të lëndëve natyrore në Republikën e Maqedonisë 2% kanë të kryer më shumë se arsim sipëror, 43% janë me arsim sipëror, madje 54% janë me arsim të lartë.

Tabela 4.3. Përvoja e punës e arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore dhe të arriturat e nxënësve në këto lëndë

	20 vjet ose më tepër		nga 10 deri 20 vjet		nga 5 deri 10 vjet		më pak se 5 vjet		Mesatarja e viteve të përvojës së punës
	nx.	rez.mes.	nx.	rez.mes.	nx.	rez.mes.	nx.	rez.mes.	
Republika e Maqedonisë	51	397	25	412	9	425	15	425	20
Mesatarja ndërkombëtare	33	480	29	480	19	475	20	471	15

Nga tabela 4.3. mund të shihet që tek ne nxënësit të cilët i mësojnë arsimtarë të grupit të lëndëve natyrore të cilët kanë përvojë pune midis 5 deri 10 vjet dhe më pak se 5 vjet arrijnë rezultate më të larta. Në nivel ndërkombëtar pamja është pak më ndryshe. Sa më të mëdha që janë vitet e përvojës së punës së arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore të arriturat e nxënësve janë aq më të larta.

Në pyetësorët për arsimtarë nga TIMSS 2011 u grumbulluan të dhëna për zhvillimin profesional të kuadrit arsimor të grupit të lëndëve natyrore në dy vitet e fundit. Në këto pyetje tek ne u përgjigjën më së paku 70% të arsimtarëve, por përfshirja e nxënësve që ata mësonin është më pak se 85%. Republika e Maqedonisë është mbi mesataren ndërkombëtare sipas përqindjes së arsimtarëve të trajnuar, më saktësisht është pothuajse në majë.

Përkatesisht, nxënësit e klasës së VIII po mësohen nga: 89% të arsimtarëve të cilët kanë përkrahje lidhur me realizimin e përmbajtjeve nga grupi i lëndëve natyrore, 64% të arsimtarëve të cilët kanë mbështetje pedagogjike për realizimin e orëve nga grupi i lëndëve natyrore, 88% të arsimtarëve që kanë fituar mbështetje për realizimin e programit arsimor, 90% kanë frekuentuar trajnime për shfrytëzimin e teknologjisë informatike në mësim, 65% kanë frekuentuar trajnime për përmirësimin e mendimit kritik të nxënësit ose zgjidhjen e problemeve dhe 88% kanë fituar trajnime për vlerësime nga grupi i lëndëve natyrore.

Më tepër se 89% të nxënësve kanë arsimtarë nga grupi i lëndëve natyrore në Republikën e Maqedonisë të cilët ndjehen „shumë mirë” të përgatitur të zhvillojnë mësim

nga grupi i lëndëve natyrore. Për sferat përmbajtësore (gjithsej 20): Biologji (7 lëmi), Kimi (4 lëmi), Fizikë (5 lëmi) dhe Gjeografi vetëm 68%.

Arsimtarët nga grupi i lëndëve natyrore u pyetën se sa vetëbesim ndjejnë gjatë ligjërimit kur: përgjigjen në pyetjet që parashtrojnë nxënësit në grupin e lëndëve natyrore, u tregojnë nxënësve metoda të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe për kryerjen e eksperimenteve shkencore, sigurojnë detyra më të vështira për nxënësit e avansuar, përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës dhe i ndihmojnë nxënësit që të çmojnë vlerën e të mësuarit të grupit të lëndëve natyrore. Madje 96% të arsimtarëve ndjehen shumë vetëbesim që punët e sipërpërmendura i bëjnë maksimalisht mirë. Të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë nga vendi ynë janë 430. Kjo përqindje e arsimtarëve është shumë mbi mesataren ndërkombëtare¹⁸. Para nesh sipas vetëbesimit të arsimtarëve nga grupi i lëndëve natyrore janë vetëm Kazakistani, Federata Ruse dhe Ukraina, por të arriturat e nxënësve të tyre janë shumë më të larta nga ato të vendit tonë. Karakteristike është që arsimtarët e shteteve të cilat kanë arritur rezultate më të larta në TIMSS 2011 nga grupi i lëndëve natyrore (Singapori dhe Republika e Koresë) ishin shumë modest në përgjigjen në këtë pyetje¹⁹. Nëse shikohen sipas komponentave gjërat e sipërpërmendura mund të konkludojmë që 96% të nxënësve i mësojnë arsimtarë të cilët përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës dhe të ndihmojnë nxënësit të çmojnë vlerën e të mësuarit matematikë, kurse në nivel ndërkombëtar kjo është 65%. Në tabelën 4.4. janë dhënë çështjet e sipërpërmendura sipas komponentave.

¹⁸ Mesatarja ndërkombëtare është 73%, kurse të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 479.

¹⁹ Në Singapor vetëm 60% të arsimtarëve ndjejnë shumë vetëbesim që i bëjnë maksimalisht mirë çështjet e sipërpërmendura, të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 595. Në Republikën e Koresë vetëm 40% të arsimtarëve ndjejnë shumë vetëbesim që i bëjnë maksimalisht mirë çështjet e sipërpërmendura, të arriturat e nxënësve që i mësojnë këta arsimtarë janë 559.

Tabela 4.4. Komponentat e vetëbesimit të arsimtarëve kur ligjërojnë grupin e lëndëve natyrore

	Përqindja e nxënësve, arsimtarët e të cilëve janë shumë vetëbesim kur ligjërojnë grupin e lëndëve natyrore				
	Përgjigjen në pyetjet që parashtrojnë nxënësit nga grupi i lëndëve natyrore	Shfrytëzimin e konceptit shkencor apo principeve për realizimin e eksperimenteve shkencore	Sigurojnë detyra më të vështira për nxënësit e avansuar	Përpiqen që të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës	Ndihmojnë nxënësit të çmojnë vlerën e të mësuarit të grupit të lëndëve natyrore
Republika e Maqedonisë	94	82	82	96	92
Mesatarja ndërkombëtare	81	72	57	65	70

Arsimtarët u pyetën edhe për kënaqësinë nga zhvillimi i tyre karrierik. Ata jepnin mendimin e tyre në raport me një shkallë katërgradëshe: sa janë të përmbushur me profesionin e tyre, sa janë të kënaqur që janë arsimtarë në shkollën e tyre, a kishin më tepër entuziazëm kur kishin filluar të ligjërojnë sesa tani, sa e rëndësishme është puna e tyre si arsimtar, a planifikojnë të vazhdojnë punën si arsimtar derisa munden dhe a janë të frustruar si arsimtar. Sipas përgjigjeve të tyre:

- 51% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që janë të kënaqur, kurse të arriturat e këtyre nxënësve janë 432;
- 47% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që janë deri diku të kënaqur, kurse të arriturat e këtyre nxënësve janë 384;
- vetëm 2% të nxënësve i mësojnë arsimtarë që nuk janë të kënaqur, kurse të arriturat e këtyre nxënësve nuk janë të potencuar.



5. Pikëpamje përmbyllëse dhe rekomandime

- 5.1. Pikëpamje përmbyllëse
- 5.2. Rekomandime

5.1. Pikëpamjet përmbyllëse

TIMSS (Trends in International Mathematics and Science Study) është studim ndërkombëtar i cili në bazë ka për qëllim të bëjë matjen e diturive të nxënësve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore (fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia) në klasën e IV dhe klasën e VIII. Matja e të arriturave në këtë studim ka dy dimensione: përmbytësor dhe kognitiv. Përfitim i rëndësishëm nga studimi TIMSS për kreatorët e politikës arsimore dhe praktikantët është përfitimi i informacioneve dhe indikatorëve valid për të arriturat e nxënësve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore të cilat sot i shfrytëzojnë në bartjen e vendimeve me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit.

Republika e Maqedonisë deri më tani ka marrë pjesë në tri cikle: TIMSS 1999, TIMSS 2003 dhe TIMSS 2011 me populacion vetëm nga klasa e tetë. Në TIMSS 2011 me populacion nxënësish nga klasa e VIII morën pjesë 42 shtete, 3 shtete me populacion nga klasa e IX dhe 14 pjesëmarrës komparativ. Nëse miren parasysht të gjithë pjesëmarrësit në studim (pjesëmarrësit komparativ, vendet me populacion nga klasa e VIII dhe vendet me populacion nga klasa e IX) vendi ynë nga matematika është në vendin e 43-të, kurse nga grupi i lëndëve natyrore në vendin e 52-të nga 59 pjesëmarrës në studim. Kjo ndoshta edhe nuk është befasi, nëse merren parasysht rezultatet e cikleve paraprake të TIMSS-it, me të cilat vendi ynë mori pjesë (edhe rezultatet e mëparshme ishin të ngjashme me TIMSS 2011). Të krahasuar mes veti rezultatet e vendit tonë nga tre ciklet e matjeve në të cilat kemi marrë pjesë, rezultatet nga TIMSS 2011 janë më të dobëta. Rezultatet e matjes së parë, TIMSS 1999, ishin befasi për opinionin, posaçërisht për atë profesional. Të dhënat nga TIMSS 2011 duhet të nxitin të gjithë të përfshirët në arsim, veçanërisht kreatorët e politikës arsimore që të ndërmarrin hapa sistematik për ndryshime arsimore nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore me qëllim të përmirësimit kritik të rritjes së diturive të nxënësve të vendit tonë nga këta lëndë.

Në këtë testim vajzat kanë arritur rezultate më të mira nga djemtë. Në raport me strukturën nacionale, nxënësit të cilët zgjidhnin testet në gjuhën maqedonase treguan rezultate statistikisht më të mira edhe nga matematika edhe nga grupi i lëndëve natyrore në raport me nxënësit të cilët zgjidhnin testet në gjuhën shqipe. Kjo pamje e të arriturave e lyp nevojën e analizave më të thella për shkaqet e vërteta lidhur me dallimet e shprehura në të arriturat e të dyja kategorive të nxënësve. Zbulimi i faktorëve të vërtetë do të jep orientime për tejkalimin e situatës së gjetur.

Nxënësit nga vendi ynë arritën rezultate më të dobëta nga grupi i lëndëve natyrore në krahasim me matematikën. Nëse i shikojmë të dhënat vetëm nga grupi i lëndëve natyrore në vendin tonë mund të konkludohet që rezultatet e nxënësve janë më të mira nga kimia, pastaj nga gjeografia dhe biologjia, dhe më të dobëta janë nga fizika.

Ndaj të arriturave të nxënësve ndikim të madh kanë: arsimimi i prindërve, a kanë nxënësit në shtëpi: dhomën e tyre, lidhje interneti dhe më shumë se 100 libra, gjegjësisht ata me resurse më të mëdha arrijnë edhe rezultate më të mëdha. Sipas përgjigjeve të

nxënësve nga vendi ynë vetëm 13% të tyre kanë më shumë se 100 libra në shtëpi, që është nën mesataren ndërkombëtare të 25%. Ndërsa, lidhje interneti dhe dhomën e tyre kanë 71% të nxënësve, që është mbi mesataren ndërkombëtare 53%. Qasje tek kompjuteri në shkollë nuk kanë vetëm 3% të nxënësve. Ndërsa 72% të nxënësve mësojnë nëpër shkolla të cilat kanë kompjuter për çdo nxënës ose nga një kompjuter për dy nxënës, por të arriturat mesatare të nxënësve në shkollat ku ka kompjuterë nuk janë shumë më të mira në raport me ata shkolla ku ka një kompjuter në 3 deri 5 nxënës ose ka kompjuterë në më tepër se 6 nxënës. Në nivel ndërkombëtar vetëm 40% të nxënësve mësojnë në shkolla të cilat kanë kompjuterë për çdo nxënës ose nga një kompjuter për 2 nxënës. Statistikisht e rëndësishme është se rezultate më të dobëta tregojnë nxënësit në shkollat ku aspak nuk ka kompjuterë, ndërsa në shkollat ku ka kompjuterë, pa dallim, për çdo nxënës ose në disa nxënës rezultatet janë më të larta dhe të ngjashme.

Shteti ynë është larg nën mesataren ndërkombëtare kur bëhet fjalë për pajisjen e shkollave me laboratorë për grupin e lëndëve natyrore, përkatësisht vetëm 37% të shkollave janë të pajisura, kurse në nivel ndërkombëtar 80%. Të arriturat e nxënësve në shkollat në të cilat ka laboratorë janë më të larta, në raport me tjerat.

Sipas mendimeve të nxënësve, madje 33% e tyre po planifikojnë të mbarojnë më tepër se arsim të lartë, kurse vetëm 13% të mbeten me arsim të mesëm, që do të thotë se nxënësit në Republikën e Maqedonisë janë të gatshëm të mësojnë dhe të përsosen.

Rreth 90% të nxënësve në Republikën e Maqedonisë kanë arsimtarë nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore që ndjehen „shumë mirë“ të përgatitur për të realizuar mësimin. Më tepër se 95% të arsimtarëve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore janë të bindur që maksimalisht mirë: përgjigjen në pyetjet e parashtruara nga nxënësit, u tregojnë nxënësve metoda të ndryshme për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e eksperimenteve shkencore, sigurojnë detyra më të vështira për nxënës më të avansuar, përpiqen të mbajnë vëmendjen e nxënësve gjatë orës dhe t'i ndihmojnë nxënësit të çmojnë vlerën e të mësuarit. Arsimtarët e shteteve që kanë arritur rezultate mbi mesataren ndërkombëtare janë më vetëkritik, kjo posaçërisht është e shprehur në shtetet aziatike.

5.2. Rekomandime

Rezultatet e arritura në këtë studim, bashkë me të dhënat e përgjithshme të fituara nga pyetësorët orientojnë ndaj disa drejtimeve të mundshëm veprimi.

- të miratohet një strategji për pjesëmarrjen e vendit tonë në projekte ndërkombëtare për matjen e të arriturave të nxënësve;
- të miratohen standarte kombëtare për të arriturat e nxënësve nga matematika dhe grupi i lëndëve natyrore bazuar në tregues real empirik të fituar në matjet nacionale dhe ndërkombëtare të të arriturave të nxënësve në matematikë dhe grupin e lëndëve natyrore;
- të përforcohen njohuritë dhe shkathtësitë e arsimtarëve (përmes përgatitjes së tyre initiale në fakultetet e mësuesisë dhe përmes modeleve të ndryshme të zhvillimit profesional) për:
 - shfrytëzimin e metodave bashkëkohore të hulumtimit dhe të mësuarit, posaçërisht të mësuarit përmes zgjidhjes së situatave problematike të lidhura me jetën reale;
 - shfrytëzimin e metodave të ndryshme, mënyrave dhe instrumentave për vlerësim formativ, me theks në shfrytëzimin e të arriturave të nxënësve për modifikimin dhe përmirësimin e arsimit të orientuar ndaj nxënësit;
 - ndërlidhjen e kriterëve për vlerësimin e nxënësve me standartet ndërkombëtare dhe nivelet e të arriturave.
- Të nxitet në kontinuitet zhvillimi profesional i arsimtarëve dhe mësimi i përgjithshëm;
- Të rishikohet cilësia e teksteve mësimore dhe të mundësohet që në mësim të shfrytëzohen materiale të shumta për hulumtim, përfshirë zhvillimin dhe shfrytëzimin e materialeve dixhitale për mësim në sferën e matematikës dhe shkencave natyrore;
- Të bëhet një analizë komparative e programeve mësimore dhe qasjeve metodike dhe të praktikave arsimore në shkollat fillore dhe të mesme të matematikës dhe grupit të lëndëve natyrore në Republikën e Maqedonisë, me ata të shteteve të cilat kanë arritur rezultate të larta në matjet ndërkombëtare, kurse kanë strukturë të ngjashme me sistemin tonë arsimor, nga aspekti i definimit të qëllimeve në mësim, përfaqësimin e përmbajtjeve dhe rezultateve të pritura të nxënësve. Në bazë të rezultateve të fituara nga analiza të ndërmirren hapat përkatës.
- Fakultetet e mësuesisë që edukojnë kuadro për mësues të ardhshëm të matematikës dhe grupit të lëndëve natyrore programet e tyre arsimore t'i afrojnë ndaj praktikës arsimore të fakulteteve të Unionit European (me theks të veçantë tek metodikat);
- Të vendoset një sistem për mbështetjen e arsimtarëve të matematikës dhe të grupit të lëndëve natyrore përmes:

- mbështetjes së përforcuar profesionale nga ana e institucioneve të ngarkuara për përkrahjen dhe përparimin e arsimit;
- mbështetjes së përforcuar profesionale dhe teknike nga ana e menaxhmentit shkollor;
- bashkëpunimit të vazhdueshëm mes arsimtarëve në shkollë;
- gërshetimit me qëllim të ndarjes së përvojave, përkrahjes dhe bashkëpunimit me arsimtarët e shkollave tjera;
- krijimit të bankave me materiale profesionale dhe shembuj të praktikës së mirë mësimore nga arsimtarët për arsimtarë;
- bashkëpunimit me pushtetin lokal për shfrytëzimin e mundësive për mësimin e matematikës dhe grupit të lëndëve natyrore jashtë shkollave.
- Të shfrytëzohen qasjet, të mirat materiale, shembujt dhe praktikat e mira të zhvilluara dhe të promovuara viteve të kaluara në kuadër të projekteve në Republikën e Maqedonisë të cilat janë të orientuara ndaj përmirësimit të mësimin të matematikës dhe grupit të lëndëve natyrore.

Literatura

- [1] Ina V.S. Mullis, Michael O. Martin, Graham J. Ruddock, Christine Y. O'Sullivan, and Corinna Preuschoff, TIMSS 2011 Assessment Frameworks, International Study Center, Boston 2009.
- [2] Michael O.Martin, Ina V.S.Mullis, Pierre Foy, and Gabrielle M.Stanco, TIMSS 2011 International Results in Science – Findings from IEA's Trends in International Mathematics and Science Study at the eighth grades, International Study Center, Boston 2012.
- [3] Ina V.S.Mullis, Michael O.Martin, Pierre Foy and Alka Arora, TIMSS 2011 International Result in Mathematics – Findings from IEA's Trends in International Mathematics and Science Study at the fourth and eighth grades, International Study Center, Boston 2012.
- [4] Ina V.S.Mullis, Michael O.Martin, Chad A. Minnich, Gabrielle M.Stanco, Alka Arora, Victoria A.S. Centurino and Courtney E. Castle, TIMSS 2011 Encyclopedia Education Policy and Curriculum in Mathematics and Science – Findings from IEA's Trends in International Mathematics and Science Study at the fourth and eighth grades, International Study Center, Boston 2012.

Përmbajtja

1. Hyrje	5
1.1. Çka paraqet TIMSS 2011?	7
1.2. Çka mundëson përfshirja në këtë studim.....	8
1.3. Kush e realizoi TIMSS 2011	10
1.4. Ekzemplar	11
1.5. Instrumentat për grumbullimin e të dhënave.....	12
1.6. Korniza konceptuale e studimit	14
2. Të arriturat e nxënësve.....	15
2.1. Mënyra e paraqitjes së rezultateve	16
2.2. Të arriturat nga matematika	17
2.3. Të arriturat nga grupi i lëndëve natyrore (fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi) ..	44
3. Faktorët që ndërlidhen me të arriturat e nxënësve	73
3.1. Ndikimi i parametrave socio-ekonomike të shtëpisë ndaj të arriturave të nxënësve	75
3.2. Ndikimi i resurseve shkollore të mësimi ndaj të arriturave të nxënësve nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore	78
3.3. Ndikimi i klimës shkollore ndaj të arriturave të nxënësve nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore	85
4. Përgatitja e arsimtarëve	91
4.1. Programet mësimore nga matematika dhe nga grupi i lëndëve natyrore.....	93
4.2. Përgatitja e arsimtarëve të matematikës	95
4.3. Përgatitja e arsimtarëve të grupit të lëndëve natyrore	98
5. Pikëpamje përmbyllëse dhe rekomandime.....	101
5.1. Pikëpamjet përmbyllëse	102
5.2. Rekomandime.....	104

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

rr. „Vasil Gjorgov” , p.n., Shkup

Për botuesin

Jusuf Arifi, drejtor i QSHP-së

d-r Beti Llameva

Reshad Ramadani

TIMSS 2011

(Trends in International Mathematics and Science Study)

RAPORTI MBI TË ARRITURAT E NXËNËSVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Përktheu dhe përshtati:

Naim Demiri

Dizajni dhe përgatitja kompjuterike:

Semire Bilalli

Tirazhi:

200 copë

Shtypi:

„AUTOPRINT T.A.SH.P.K”

ISBN: 978-608-4692-02-7



9 786084 692027